

VENDIM
Nr.206, datë 16.4.2004

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.363, DATË 18.7.2002 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR VENDOSJEN E OPONENCËS TEKNIKE PËR PROJEKTET E
NDËRTIMIT TË OBJEKTEVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 e 18 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” dhe të neneve 124 dhe 128 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.363, datë 18.7.2002 të Këshillit të Ministrave të bëhet kjo shtesë:
Pas pikës 4 shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:
“4/1. Tarifat për oponencën teknike të projekteve të jenë sipas lidhjes, që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

TARIFAT PËR OPONENCËN TEKNIKE PËR PROJEKTET E NDËRTIMIT TË OBJEKTEVE

Tarifat për oponencën teknike për projektet e ndërtimit të objekteve i referohen tarifës në përqindje të projektimit, drejtimit dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit, si më poshtë:

Kushtimi (milion/lekë)	Tarifa (në%)
100,00	7.0
150,00	6.5
200,00	6.0
300,00	5.5
Mbi 300,00	5.0